



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKËS
Zyra e Prokurimit

ANEKS KONTRATË
Punë – shtesë

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala, zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe ne PMK (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.P.N. HIDROTERM SH.P.K, me seli Suhareke, me NUI: 810634867 të cilën e përfaqëson Nol Paloka (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike përkryerjen e punëve të shënuara me poshtë:

Rregullimi i rruges Brigada 123 Qender- Suhareke-Pune shtese
Nr i prokurimit 624-19-059-5-1-1/5/-624-20-725-5-2-5

Neni 1 Lënda e kontratës është punë shtesë **Rregullimi i rruges Brigada 123 Qender- Suhareke-Pune shtese**

Ne bazë të kërkesës së mbikëqyersit datë 04.03.2020 dhe aprovimit të punëve shtesë nga menaxheri i kontratës të datës 04.03.2020 dhe Aktvendimit 01-Nr 114-1420 të ZKA— datës 04.03.2020 dhe njoftimit në KRPP të datës 06.03.2020 ZP ka zhvilluar procedurën punë shtesë për këtë procedurë.

Neni 2

Operatori Ekonomik është i obliguar t'i kryen të gjitha punët shtesë të kontraktuara në pajtim me specifikimet teknike të dhëna me paramasa dhe paralogari nga organi mbikëqyrës në afat prej 90 ditë pune.

Neni 3

Çmimi është i dhënë në euro dhe vlera e përgjithshme e kontratës për kryerjen e punëve shtesë është: 79.943,14€ (Shtatedhjet e nente mije e nenteqind e katerdhjet e tre euro e katermbedhjet cente).

Autoriteti kontraktues është i obliguar të bëjë pagesën e faturës në numrin e xhirollogarisë bankare të OE.

Pas përfundimit të punëve shtesë të pranuar me raportin e nënshkruar nga organi mbikëqyrës dhe menagjeri i kontratës.

Çmimi është i dhënë në euro ku janë të përfshira të gjitha taksat dhe tatimet e aplikuara në Kosovë.

Çmimi i përmendur në Nenin 3 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë për funizime shtesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës

Konform nenit 1.3 të kontratës bazë, OE duhet të sjell sigurimin shtesë për ekzekutim të kontratës, në vlerë prej 10% të aneks kontratës e që është 7.994.31

Neni 4

Operatori Ekonomik punët duhet t'i fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe t'i përfundojë në afat sipas nenit 2 të kontratës.

Nëse OE vonon në kryerjen e punimeve, për çdo ditë pune vonese është i obliguar të paguaj 1% dënim deri në maksimumin 10% të vlerës së kontratës.

Neni 5

OE është përgjegjës për kryerjen e punimeve, sipas dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike të nënshkruara.

Neni 6

Nëse kemi shkelje të kontratës nga kontraktori ai duhet t'i eliminon ato në afatin e dhënë, në të kundërtën Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shkëpus kontratën e në të dy rastet të kërkojë kompensimin e dëmit sipas sigurimit të ekzekutimit të kontratës.

Neni 7

Nëse Operatori Ekonomik nuk i përmbahet në përpikëri kushteve nga kontrata, Autoriteti Kontraktues mund ta shkëpus kontratën duke paralajmëruar kontraktorin 5 ditë para shkëputjes.

Neni 8

Nëse ka mosmarrëveshje, palët mund të kërkojnë vendim gjyqësor nga Gjykata Kompetente e Kosovës.

Neni 9


Kontrata është e hartuar në gjuhën shqipe në tre ekzemplar prej të cilave një e merr kontraktori dhe dy në dosje të lëndës.

Neni 10


Kjo kontratë e punëve shtesë për projektin: **Rregullimi i rruges Brigada 123 Qender-Suhareke-Pune shtesë** i bashkangjitet kontratës baze për këtë projekt.


Numri kontaktues i OE është: 029271488 dhe Email: info@hidroterm.info

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafe Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2020
Vula:	vv

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Noi Paloka
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2020
Vula:	vv



Paramasa dhe paralogaria për punë shtes për Kanalizim Fekal dhe Atmosferik

Lot 3: (P79-P83)-Lot 4:(83-94)					
PUNIMET NDERTIMORE					
1	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR KANALIZIM FEKAL				
1.3	Germimet dhe mbushjet	Njesia	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
1.3.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III, IV dhe V për ndërtimin e kanalit për vendosjen e gypave me makinë dhe dorë. Llogaria në m³ të dheut të gërmuar.				
1.3.1.1	- me makinë 90 %	m³	1,244.00	5.00	6,220.00
1.3.1.2	- me dorë 10 %	m³	138.00	8.00	1,104.00
1.3.2	Sigurimi ,transporti dhe vendosja e rrës 0-4mm në kanal, ashtu që së pari të ndërtohet baza me trashësi të rrës sipas rekomandimeve për çdo gypë, ndërsa pas montimit të gypit të hudhet rëra për rreth dhe mbi gyp .	m³	354.76	15.00	5,321.40
1.3.3	Sigurimi dhe vendosja e zhavorit me shtresa për mbushjen e kanalit me ngjeshje çdo 20-30cm.	m³	720.16	12.00	8,641.92
1.3.4	Largimi i dheut të tepërt të gërmuar deri në deponin legale të cilën e cakton investitori apo organi mbikqyrës.	m³	1,382.45	2.00	2,764.90
1.6	Punët Montuse			€ / Pos :1.3	24,052.22
		Njesia	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
1.6.1	Sigurimi dhe montimi i gypave të kanalizimit fekal të llogaritur.Gypat duhet të montohen sipas kushteve teknike të egzekutimit dhe duhet tu ipet pjertësia e projektuar dhe e njëjta të verifikohet aty për aty me nivelë. Si dhe lidhja e tubit kokë-kokë të bëhet me vendosjen e rrethit izolues ose "diktum"-it				
1.6.1.1	- Gypa të PE SN-8 Ø-630mm	m'	0.00	32.00	0.00
1.6.1.1	- Gypa të PE SN-8 Ø-500mm	m'	369.00	25.00	9,225.00
				€ / Pos :1.6	9,225.00
Gjithësej Kanalizimi fekal				€ / Totali:	33,277.22
2	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR KANALIZIM ATMOSFERIK				
2.1	Punët përgaditore				
2.3	Germimet dhe mbushjet	Njesia	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
2.3.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III, IV dhe V për ndërtimin e kolektorit për ujërat atmosferi p makinë dhe dorë. Dimensionet e kanalit janë 2.7mx2.5m				
2.3.1.1	- me makinë 90 %	m³	3,930.00	3.00	11,790.00
2.3.1.2	- me dorë 10 %	m³	436.70	4.00	1,746.80
2.3.3	Sigurimi dhe vendosja e zhavorit me shtresa rreth kolektorit me ngjeshje çdo 20-30cm.	m³	718.90	12.00	8,626.80
2.3.4	Largimi i dheut të tepërt të gërmuar deri në deponin legale të cilën e cakton investitori apo organi mbikqyrës.	m³	4,366.70	2.00	8,733.40
				€ / Pos:2.3	30,897.00



2.6	Punët Betonike dhe Montuse	Njesia	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
2.6.2	Sigurmi dhe vendosja e betonit të varfen C12 për ndertimin e kolektorit. Llogaria është bërë për 190m gjatesi	m³	31.00	55.00	1,705.00 ✓
2.6.3	Ndërtimi i kolektorit për ujërat atmosferik me dimensione 2.7*2.5*2.3 sipas detajit të dhene. Kolektori duhet të ndertohet në vend nga betoni i armuar i pa pershkueshem nga uji, klasa betonit duhet të jetë C25, çdo 12m duhet të përdoret waterstop ne vendet e vazhdimit të rezervarit. Pjesa e sipërme e kolektorit duhet të jetë me pllakë të parafabrikua, me mundësi largimi per rastet emergjente. Kolektori duhet të ndertohet sipas pjerrtesis së dhënë në projekt. Llogaria është bërë për 190 m gjatesi	m³	17.82	77.00	1,372.14 ✓
2.6.4	Sigurmi dhe vendosja e armaturës sipas specifikacionit në strukturë. Llogaria është bërë për 190m gjatesi	kg	15,864.73	0.80	12,691.78 ✓
Gjithësej Kanalizimi Atmosferik				€ / Pos2.6	15,768.92 ✓
Gjithësej Kanalizimi Fekal dhe Atmosferik				€ / Totali:	46,665.92 ✓
				€ / Totali:	79,943.14 ✓

